



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.188/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit LDK-AKR, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Gjilan për shkak të vendosjes së posterëve në shtyllë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.06.2017, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.188/2017 e datës 09.06.2017, nga Koalicionit LDK-AKR, me seli në Prishtinë,

A r s y e t i m

Me datën 09.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Koalicionit LDK-AKR, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datën 09.06.2017 në rrugën afër spitalit rajonal në Gjilan, aktivisti i tyre ka vërejtur se në shtyllë publike ishte vendosur posteri i kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, nuk mund të vërtetohet shkelja e nenit 33 pika (b) të LVP-së, pasi që materiali zgjedhor i LVV-së, i cili thuhet se është vendosur tek spitali rajonal në Gjilan nga fotografia e ofruar nuk mund të identifikohet se aty ka ndodhur shkelja.

Mbi këtë bazë paneli konsideron se koalicioni në fjalë nuk ka kryer shkelje të neni 33 pika (b) të LZP-së dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.188/2017 më datën 10.06.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.